

Në kryendeshjen e Javes se 15-te, Hysi ka fituar bindshem ndaj kampionit ne fuqi



Prishtina me rezultatin e paster 2:0. Nje ndeshje e hapur por pa shume raste per shenim. Hysi dominoi pjesen me te madhe te lojes. Goli i parë u shënua në fillim të takimit. Ne minuten e 5-te, nje goditje denimi e ekzekutuar nga Mentor Zhdrella perfundon ne rrjete, pas devijimit te Yll Prekopukes.

Ne minuten e 79-te nje gjuajtje ne drejtim te portes se Prishtines nga ana e Livorekes, ndalohet me dore jashte zone nga ana e portierit Mushica. Gjyqtar kryesor Vula me te drejte e nxjerr portierin Prishtinas nga loja me karton te kuq. Debuton me sukses, 19 vjecari portier reserve Alban Muciqi i cili nuk eshte ne gjendje te ndaloje gjuajtjen e Perparim Osmanit ne minutat e fundit shtese. Me kete fitore Hysi ngjitet ne vendin e dyte me 25 pike, 3 me pak se Llamkos Kosova